

## STATUT

### I

#### SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### “LIV HOSPITAL TIRANA” SHPK

Ne Tirane, sot me date 01 Prill 2021, ne respektim te kerkesave te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar, nenshkruhet ky statut per krijimin e shoqerise “LIV HOSPITAL TIRANA” SHPK nga ortaku, si me poshte :

1. **Zj. Alketa Brahushaj**, e bija e Sabriut dhe Myzejenit, e datelindjes 16/02/1973, lindur ne Tirane, Shtetase Shqiptare, dhe banuese ne Tirane, me adrese Rr. S.Gabrani, Nd. 158, Njesia Administrative Nr.6, 1027, Tirane, me Nr. Karte Identiteti ID H35216063L, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar,

bazuar ne Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, si dhe Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit”, i ndryshuar,

#### Neni 1

##### Emri dhe forma

Shoqeria quhet “LIV HOSPITAL TIRANA” SHPK, (shoqeri me pergjegjesi te kufizuar)

#### Neni 2

##### Selia

Shoqeria e ka seline ne:



Tirane, Njesia Bashkiake Nr.5, Rr. Ismail Qemali, Pall 31/1, kati 1, Zona Kadastrale 8270, Nr Pasurie 3/100+1-2, Shk.1, Ap.2, Tirane

Nr.Celular : 00355/ 068 206 2711

Email : [keti\\_brahushaj@hotmail.com](mailto:keti_brahushaj@hotmail.com)

Veprimtaria e saj do te shtrihet ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Shoqeria ka te drejte te krijojë brenda dhe jashte vendit dege, zyra perfaqesimi.

Me vendim te asamblese se pergjithshme mund te krijohen, te ndryshohen ose anulohen (nese jane te krijuara) dege dhe zyra perfaqesimi brenda dhe jashte Shqiperise.

### Neni 3

#### Objekti i veprimtarise

Objekti i Veprimtarise se Shoqërisë **“LIV HOSPITAL TIRANA” SH.P.K.** është ofimi i shërbimeve ne fushen e transferimit te pacienteve jashte vendit, si me poshte :

- Konsulta Mjeksores;
- Transferim Pacientesh jashte vendit;
- Laborator Mjekesor;

### Neni 4

#### Kohezgjatja dhe vula

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pakufizuar.

Me vendim te asamblese se pergjithshme kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit mund te kufizohet ose te zgjerohet dhe ky vendim dergohet menjehere per regjistrim ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit te Biznesit (QKB).



Shoqeria ka vulen dhe specimentet e saj.

### **Neni 5**

#### **Te drejtat dhe detyrat e ortakut/ortakeve**

Ortakët gezojnë kryesisht këto të drejta :

Marrin pjesë në drejtimin dhe administrimin e shoqërisë.

Marrin pjesë në ndarjen e fitimeve në përpjestim me kuotat e pjesëmarrjes së tyre në kapitalin themeltar, dhe në përputhje me procedurat e parashikuara nga ligji, aktet nënligjore e statuti.

Marrin pjesë në shpërndarjen e aktivitetit që do të rezultojë nga bilanci i likuidimit. Kane të drejtë vote në përputhje me kuotat e pjesëmarrjes në kapitalin themeltar.

Mund të përfaqësohet nga një person tjetër mbi bazën e një prokure. Asnjë ortak nuk mund të përjashtohet nga asamblëja e shoqërisë.

Të kërkojë dhe t'i japin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen financiare dhe tregtare të shoqërisë, si dhe t'i kërkojë të gjitha dokumentat e shoqërisë, ato që kanë të bëjnë me kalkulimin e rezultatit ekonomik të bilancit kontabel apo të çfaredolloj llogarie.

Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të gjitha vendimet e marra prej tij regjistrohen në një regjister të vendimeve.

Nëse ortaku pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotes, atëherë ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e demit të shkaktuar. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga casti i cenimit.

### **Neni 6**

Ortakët kanë këto detyra kryesore:

Të angazhohen për realizimin e objektivave të shoqërisë.

Të ruajnë sekretin tregtar dhe mos t'u japin informacion konkurrenteve në treg, lidhur me të dhëna të cilat ndikojnë në rritjen e aktivitetit dhe efektivitetit të shoqërisë.



### Neni 7

Ne shoqerine me dy a me shume ortake, ortaket kane te drejten e parablerjes se kuotave te secilit ortak qe deshiron t'ua tjetersoje ate te treteve.

Ortaku qe deshiron te tjetersoje kuoten e vet, duhet t'i komunikojte me shkrim ortakut tjeter ose ortakeve, nje shkrese duke i treguar bleresin, cmimin e ofruar dhe menyren e pageses.

Ortaket qe cmojne te drejten e parablerjes, duhet t'i komunikojne me shkrim pergjigjen ortakut te interesuar, brenda nje muaj nga data e marrjes se njoftimit. Mungesa e komunikimit brenda ketij afati, barazohet me mos ushtrimin e te drejtes se parablerjes.

Me mos ushtrimin e te drejtes se parablerjes, procedura e transferimit te kuotave te te tretet behet ne zbatim te nenit 18 te ketij statuti.

### Neni 8

Ortaket e shoqerise perballojne humbjet vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Shoqeria "LIV HOSPITAL TIRANA" SHPK nuk pergjigjet per borxhet, debite vetjake te ortakeve te lindura para apo pas krijimit te shoqerise.

### Neni 9

#### Kontributi i ortakeve te shoqerise

Kapitali themeltar i shoqërisë "LIV HOSPITAL TIRANA" SHPK është 100.000 leke, i ndare ne 1 kuote.

Kontributi i ortakut themelues ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e saj te meposhtme :

1. **Ortaku Themelues Alketa Brahushaj:** Eshte Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 100.000 (njqindmije) leke, me 100 % pjesemarrje ne kapitalin themeltar te shoqerise.



Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luejtshme/te paluejtshme apo te drejta)

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

#### **Neni 10**

##### **Bilanci**

Kur shoqeria pushon aktivitetin e saj, pasi ajo ka shlyer cdo detyrim, pasurine neto qe rezulton nga bilanci i likuidimit, e shperndan mes ortakeve sipas kuotave te pjesemarrjes.

#### **Neni 11**

Shoqeria eshte pronare e pasurise se saj dhe e perdor ate me qellim permbushjen e objektit te veprimtarise se saj.

Shoqeria gezon te drejten e mbrojtjes se pasurive te saj ne perputhje me Legjislacionin vendas e nderkombetar.

#### **Neni 12**

Shoqeria nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar, pasi te jene zbritur po te jete e nevojshme humbjet e vitit te meparshem, mund te lere menjane nje shume me vlere te pakten 1/20 e tij,

A large, stylized handwritten signature in black ink, appearing to be a cursive representation of a name, possibly 'P. J. ...'.

e cila destinohet per formimin e nje fondi rezerve, te quajtur "rezerve e domosdoshme". Kjo lenie menjane nuk eshte e detyrueshme.

Vecimi, perdorimi i cdo fondi special percaktohet nga asambleja ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar.

### **Neni 13**

Fitimi qe do te shperndahet, perbehet nga fitimi i vitit financiar, te cilit i jane zbritur shumat menjane per rezerven sipas ligjit ose statutit dhe nga ana tjeter jane zbritur apo shtuar respektivisht humbjet apo fitimet nga vitet e meparshme.

### **Neni 14**

Ushtrimet e shoqerise mbyllen me 31 Dhjetor te cdo viti.

Organi administrativ eshte i detyruar te perpiloje bilancin, i cili duhet te pasqyroje te gjithë aktivitetin e shoqerise dhe te percaktoje perkatesisht fitimet, humbjet dhe ndarjen e tyre.

### **Neni 15**

Forma e bilanceve dhe llogarive ekonomike te shoqerise mbahen nga organet e saj administrative duke respektuar ligjin dhe aktet nenligjore, ne kete fushe.

Kontabiliteti dhe dokumentacioni mbeshtetes arshivohen ne shoqeri dhe institucionet perkatese shteterore, tatimore etj.

### **Neni 16**

#### **Transferimi i pjeseve te kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;

A handwritten signature in black ink, consisting of a large, stylized initial 'P' followed by a cursive name, all enclosed within a large, irregular oval shape.

d) dhurimit;

e) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar behen me akt noterial.

#### **Neni 17**

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie, sipas dispozitave te Kodit Civil.

Ato jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

#### **Neni 18**

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e shumices se ortakeve qe perfaqesojne te pakten 51 % te pjeseve te kapitalit themeltar.

Ne rast se shoqeria refuzon te jape miratimin e transferimit, ortaket, brenda nje muaji nga data e ketij refuzimi, duhet te blejne apo te lejojne blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar me vleften qe percaktohet nga nje ekspert. Eksperti caktohet nga palet. Kur ata nuk merren vesh ndermjet tyre, ai caktohet nga Gjykata.

#### **Neni 19**

##### **Asambleja e pergjithshme**

Asambleja e pergjithshme eshte organi me i larte drejtues dhe vendimor, qe ushtron kompetencat e njohura me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

A handwritten signature in black ink, consisting of a large, stylized initial 'A' followed by several loops and a long horizontal stroke extending to the right.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise
- b) ndryshimet e statutit
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve
- d) emerimin e shkarkimin e likujdvesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- dh) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te ketij neni
- e) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g) zmadhimin e zvogelimin e kapitalit
- gj) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- h) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- i) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese
- m) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Nese shoqeria zoterohet nga nje ortak, te drejtat dhe detyrimet e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga ortaku i vetem, te gjitha vendimet e marra prej tij regjistrohen ne nje regjister te vendimeve.

A handwritten signature in black ink, consisting of a large, stylized initial 'P' followed by a series of loops and a long horizontal stroke extending to the right.



## **Neni 20**

### **Thirrja e asamblese**

Asambleja thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese apo nepermjet postes elektronike, jo me vone se 7 dite para dates se parashikuar per mbledhjen, duke njoftuar vendin, daten, oren dhe rendin e dites.

Asambleja thirret nga administratori, apo ortaket, te cilet perfaqesojne te pakten 5 perqind te totalit te votimeve ne asamblene e pergjithshme.

Asambleja thirret nese bilanci vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton apo ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

## **Neni 21**

### **Kuorumi**


Kur per marrjen e vendimeve kerkohet shumice e zakonshme, asambleja mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 perqind te kuotave.

Kur per marrjen e vendimeve kerkohet shumice e kualifikuar, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se 50 perqind te numurit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese apo mjete elektronike.

Nese asambleja nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te lartepemendur, atehere asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

## **Neni 22**

Ne respektim te kerkesave te nenit 21 per kuorumin e duhur te mbledhjeve te asamblese, asambleja vendos me tri te katertat pergind te votave te ortakeve pjesemarres per ndryshimin

A handwritten signature in black ink, consisting of a large, stylized initial 'P' followed by a cursive name.

e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te rregjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Ne raste te tjera, pervec kur parashikohet ndryshe me ligj apo ne kete statut, asambleja vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
- d) percaktimin e shperblimeve
- e) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- f) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- g) miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB-se per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### **Perjashtimi nga e drejta e votes**

1.Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

A handwritten signature in black ink, consisting of a large, stylized initial 'D' followed by a cursive name, all enclosed within a large, sweeping oval loop.

2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

### **Neni 23**

Votimi mund te jete: i hapur apo i fshehte. Menyra e votimit percaktohet ne marreveshje te ortakeve.

Proces-verbalet e mbledhjeve firmosen nga mbajtesi i proces-verbalit dhe kryetari. Administratori i shoqerise eshte pergjegjes per ruajtjen e proces-verbaleve.

### **Neni 24**

#### **Administrimi**

Shoqeria administrohet nga nje person fizik, i cili mund te jete ose jo ortak i shoqerise.

**Administrator i shoqerise eshte Zj. Alketa Brahushaj, e bija e Sabriut dhe Donikes, e datelindjes 16/02/1973, me Nr. Karte Identiteti ID H35216063L.**

Administratori ushtron funksionin e tij me afat 5 vjecar, me te drejte riprteritje, nga data 01.04.2021 deri ne daten 01.04.2026.

Ai mundet qe te emeruje perfaqesues me prokure per akte te vecanta.

### **Neni 25**

Administratori ka te gjitha kompetencat per te administruar veprimtarine tregtare te shoqerise, si dhe te perfaqesoje ate, ka per detyre te mbaje dokumentacionin dhe librat kontabel, te pergatise e nenshkruaje bilancin vjetor, kryhen regjistrimet ne Qendren Kombetare te

Rregjistrimit te Biznesit, raporton para asamblese dhe i paraqet asaj dokumentacionin per miratim. Ai ushtron edhe kompetenca te tjera te parashikuara ne ligj.

Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjithshme, ne rastet kur:



-sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim

-shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 % te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 % te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Ne se asambleja e pergjithshme emerone me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

### **Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14,15,17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet :

- 1.a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita
- c) te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim

A handwritten signature in black ink, consisting of a large, stylized initial 'P' followed by a series of loops and a long horizontal stroke extending to the right.

d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise

e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem

2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te aresyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur,ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundersiztim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 dhe 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundersiztim me dispozitat e ligjit "PerTregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryhen veprimet e meposhtme:

a) u kthen oratakeve kontributet

b) u paguan ortakeve interesa apo dividente

c) u shperndan aktivet shoqerise

d) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet

e) jep kredi

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i

asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

A handwritten signature in black ink, consisting of a large, stylized initial 'A' followed by a series of loops and a long horizontal stroke extending to the right.

### **Neni 26**

Emerimi, shkarkimi i personelit-stafit te punes se shoqerise dhe caktimi i pages se tyre, percaktohet me vendim te asamblese.

Pezullimi nga puna mund te behet vetem nga administratori, deri ne marrjen e vendimit perfundimtar nga asambleja.

Maredheniet e punes mes shoqerise dhe stafit, rregullohen ne baze te Kodit te Punes.

### **Neni 27**

Raporti i administrimit, inventaret dhe llogarite vjetore te hartuara nga administratori, i nenshtrohet miratimit te asamblese brenda nje afati prej 6 muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar.

Cdo ortak ka te drejte te paraqese pyetje me shkrim, te cilave administratori duhet t'i pergjigjet ne mbledhje. Ortaku ka te drejte te marre ne cdo moment dokumentet e mesiperme; ai mund te ndihmohet nga nje ekspert i zgjedhur prej tij.

### **Neni 28**

#### **Kontroli**

Ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar qe mbulon kete fushe, shoqeria cakton ekspert kontabel te autorizuar.

### **Neni 29**

#### **Prishja**

Shoqeria priset:

-me vendim te asamblese se pergjithshme

-me hapjen e procedurave te falimentimit

A handwritten signature in black ink, consisting of a large, stylized initial 'P' followed by several loops and a long horizontal stroke.

- nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise
- me vendim te gjykates

### **Neni 30**

#### **Likujdimi**

Asambleja e pergjithshme emerone likujduesin, ne rastet kur shoqeria priset me vendim gjykate, likujduesi emerohet nga gjykata.

Administratori i shoqerise njofton Qendren Kombetare te Rregjistrimit te Biznesit, per emerimin e likujduesit me te dhenat e tij.

Me hapjen e procedurave te likujdimit, emertimi i shoqerise pasohet nga shenimi "ne likujdim e siper".

Likujduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratorit nga data e emerimit te tij.

### **Neni 31**

#### **Ç'rregjistrimi**

Shoqeria ç'rregjistrohet nga QKR-ja pasi kryhen te gjithet formalitetet e parashikuara ne ligj per mbylljen e likujdimit.

Ç'rregjistrimi behet :

- Vullnetarisht nga vete shoqeria
- Ne baze te nje vendimi gjyqesor te formes se prere
- Sipas parashikimit te ligjeve te posacme

### **Neni 32**

Per çdo gje qe nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete statut, referimi do te behet ne Kodin Civil, Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar, ne



Ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistriimit", i ndryshuar, ne Legjislacionin Shqiptar ne pergjithesi, perfshire aktet nenligjore. Mosmarveshjet qe mund te lindin do te zgjidhen me mirekuptim dhe kur nuk arrihet kjo, do te zgjidhen ne rruge gjyqesore.

Ky statut u përpilua ne tre kopje origjinale, nje kopje per administratorin, nje kopje per Banke, dhe kopja tjeter depozitohet ne dokumentacionin e shoqërisë.

Ky statut pasi u lexua, u kuptua dhe u gjet konform vullnetit te ortakut themelues, nenshkrhet prej tij me vullnet te lire e te plote.

Ortaku Themelues i Shoqërisë **"LIV HOSPITAL TIRANA" SHPK**

(ORTAKU THEMELUES)

**Alketa Brahashaj**

A handwritten signature in black ink, appearing to be 'Alketa Brahashaj', enclosed within a large, thin, hand-drawn oval loop.